



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 71/6 prot

Datë 13/02/2024

V E N D I M
Nr. 169/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13/02/2024 me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. REF-92678-12-29-2023, me objekt “*Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve*” me fond limit 144.333.300 Lekë, pa TVSH, vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.389.423,37 (një milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre presje tridhjetë e shtatë) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. REF-92678-12-29-2023, me objekt “*Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve*” me fond limit 144.333.300 Lekë, pa TVSH, vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.389.423,37 (një milion e treqind e tetëdhjetë

e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre presje tridhjetë e shtatë) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

- Ankimues:** Operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK, me NIPT: L42202028V
Adresa: Rruga “Margarita Tutulani”, Pallati Viridario 1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.01.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Proçedurë e Hapur*” me Nr. REF-92678-12-29-2023, me objekt “*Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve*” me fond limit 144.333.300 Lekë, pa TVSH, vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.389.423,37 (një milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre presje tridhjetë e shtatë) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 11.01.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/3748 dhe me nr. 71 prot., datë 11.01.2024 e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesat e plota të ankimuesve.

II.4. Në datën 12.01.2024 operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, formularin e ankesës në mënyre shkresorë protokolluar me tonën me nr. 71/2 prot., datë 12.01.2024.

II.5. Me shkresën nr. 18985/9 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 71/3 prot., datë 25.01.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomikë ankimues “Primus Albania” SHPK.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 18985/9 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 71/3 prot., datë 25.01.2024 rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht pretendimet e ankimuesit, si më poshtë vijon:

“[...].... në lidhje me pikën e parë të ankesës

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se:

Përsa më sipër, vlerësojmë se ankesa e operatorit ekonomik qëndron dhe si rrjedhojë pranohet. Njësia e prokurimit do të vijojë me hedhjen e një shtojce me ndryshimet përkatëse.

... së dyti, AK në specifikimet teknike përkatësisht në pikën 2.3 ka kërkuar si më poshtë vijon:
... Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se:
Përsa më sipër, vlerësojmë se ankesa e operatorit ekonomik qëndron dhe si rrjedhojë pranohet. Njësia e prokurimit do të vijojë me hedhjen e një shtojce me ndryshimet përkatëse.

... Së treti, AK në shtojcën 5 në formularin e specifikimeve teknike ka kërkuar si më poshtë vijon:

... Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se:

Referuar sa më sipër shërbimi i mirëmbajtjes zëri 7 në tabelë, ai fillon 15 ditë nga nënshkrimi i kontratës dhe zgjatet për tre vite. Ndërsa shërbimet e tjera të përcaktuara në zërat 1, 2 dhe 3 (të tabelës) e që kanë Të bëjnë me përmirësime të sistemit e që si të tilla kanë Nevojë Për zhvillim, kërkohet të lëvrohen brenda 6 muajve. Pas lëvrimit (dhe pranimit) këto përmirësime kërkohet të mirëmbahen deri në përfundimin e përgjithshëm të kontratës.

Për sa më sipër, konfirmojmë edhe një Herë Që afatet e kontratës 36 muaj ose ndryshe 3 vite!

... Së katërti, AK në shtojcën 5 në formularin e specifikimeve teknike ka kërkuar si më poshtë vijon:

... Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se:

Lidhur me kërkesën për lidhjen e sistemit të pagave, vërejmë se, kërkesat bazë Përcaktohen në kërkesat “Përmirësim dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (ëeb service) me palët e treta” në pikën 4.1.1. Kërkear funksionale, të Shtojca 5. FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, Termave të Referencës së shërbimit.

Ndërkohë që lidhur me planin e zbatimit të shërbimeve të përmirësuar, në Shtojcën. FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, paragraph 6. TABELA E ZËRAVE, pika 2 thuhet: ‘përmirësim dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (ëeb service) me palët e treta. Lidhja me 1 nga Bankat (*)’ ndërsa shënimi (*) në fund të tabelës përcakton: ‘Shënim (*): Plani i lidhjes për secilën nga Bankat, do të kryhet përgjatë periudhës së mirëmbajtjes së sistemeve. Grupit të punës së UKT që do të ndjek zbatimit të projektit, dhe koordinimin me Bankat për realizimin e lidhjeve. Plani i integritimeve, do të përcaktohet nga UKT dhe OE do të njoftohet paraprakisht (për të lejuar përgatitjen e personelit të OE) të paktën dy javë para cdo fillim integrimi’.

Për më shumë, vërejmë se:

- Numri i bankave, që do të bashkohen në këtë shërbim të përmirësuar është në varësi të vetë bankave apo vullnetit të tyre për t’ju bashkuar shërbimit. Numri maksimal i mundshëm është sa numri i bankave që do të operojnë Në Shqipëri përgjatë 3 viteve të zbatimit të kontratës (pra i papërcaktuar);
- Gjatë lëvrimit të shërbimit, OE kërkohet që brenda 6 muajve të kryej të bëj lidhjen e suksesshme me njërin nga bankat;
- Në vijim (brenda shërbimit të mirëmbajtjes, zëri 7 i tabelës ‘Mirëmbajtje e Sistemit të Faturimit Al-Billing, reader, Taksa dhe ËS të pagesave për periudhë vjecare’) operatori kërkohet të ofrojë Mbështetje teknike në procesin e lidhjes të cdo banke tjetër, që do të zbatojë Këtë shërbim.

- *Për cdo lidhje të re me bankat, kërkohet që 'plani i integrime, do të përcaktohet nga UKT dhe OE do të njoftohet paraprakisht (për të lejuar përgatitjen e personelit të OE) të paktën dy javë para cdo fillim integrimi'.*

.... Së teti : AK në pika 2.7 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë vijon:

... Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

b. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

To prove the fulfillment of this criterion, economic operator must submit the following documentation for the above-mentioned employees:

b. Relevant certificates. In case the certificates are in a foreign language, the economic operator must present them translated according to the applicable legal provision in force.

Operatori ekonomik ankimes kërkon sqarim/kroigjimin e kësaj të dhëne/kërkese duke qenë se ka paqartësi përse kohë Oferta në gjuhë të huaj pranohet.

Komisioni i shqyrtimit të Ankesave ju bën me dije se,

Përse mësipër, gjykojmë se ankesa e operatorit ekonomik është e qëndron dhe si rrjedhojë pranohet. Njësia e prokurimit do të vijojë me hedhjen e një shtojce me ndryshimet përkatëse.[...]

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 18985/9 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 71/3 prot., datë 25.01.2024 rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes "Primus Albania" SHPK ku ka vendosur që të pranojë pjesërisht pretendimet e ankimesit, si më poshtë vijon:

"[...].... në lidhje me pikën e parë të ankesës

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se:

Përse më sipër, vlerësojmë se ankesa e operatorit ekonomik qëndron dhe si rrjedhojë pranohet. Njësia e prokurimit do të vijojë me hedhjen e një shtojce me ndryshimet përkatëse.

... së dyti, AK në specifikimet teknike përkatësisht në pikën 2.3 ka kërkuar si më poshtë vijon:
... Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se:
Përsa më sipër, vlerësojmë se ankesa e operatorit ekonomik qëndron dhe si rrjedhojë pranohet. Njësia e prokurimit do të vijojë me hedhjen e një shtojce me ndryshimet përkatëse.

... Së treti, AK në shtojcën 5 në formularin e specifikimeve teknike ka kërkuar si më poshtë vijon:

... Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se:

Referuar sa më sipër shërbimi i mirëmbajtjes zëri 7 në tabelë, ai fillon 15 ditë nga nënshkrimi i kontratës dhe zgjatet për tre vite. Ndërsa shërbimet e tjera të përcaktuara në zërat 1, 2 dhe 3 (të tabelës) e që kanë Të bëjnë me përmirësime të sistemit e që si të tilla kanë Nevojë Për zhvillim, kërkohet të lëvrohen brenda 6 muajve. Pas lëvrimit (dhe pranimit) këto përmirësime kërkohet të mirëmbahen deri në përfundimin e përgjithshëm të kontratës.

Për sa më sipër, konfirmojmë edhe një Herë Që afatet e kontratës 36 muaj ose ndryshe 3 vite!

... Së katërti, AK në shtojcën 5 në formularin e specifikimeve teknike ka kërkuar si më poshtë vijon:

... Komisioni i shqyrtimit të ankesave ju bën me dije se:

Lidhur me kërkesën për lidhjen e sistemit të pagave, vërejmë se, kërkesat bazë Përcaktohen në kërkesat “Përmirësim dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (ëeb service) me palët e treta” në pikën 4.1.1. Kërkear funksionale, të Shtojca 5. FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, Termave të Referencës së shërbimit.

Ndërkohë që lidhur me planin e zbatimit të shërbimeve të përmirësuar, në Shtojcën. FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, paragraph 6. TABELA E ZËRAVE, pika 2 thuhet: ‘përmirësim dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (ëeb service) me palët e treta. Lidhja me 1 nga Bankat (*)’ ndërsa shënimi (*) në fund të tabelës përcakton: ‘Shënim (*): Plani i lidhjes për secilën nga Bankat, do të kryhet përgjatë periudhës së mirëmbajtjes së sistemeve. Grupit të punës së UKT që do të ndjek zbatimit të projektit, dhe koordinimin me Bankat për realizimin e lidhjeve. Plani i integritimeve, do të përcaktohet nga UKT dhe OE do të njoftohet paraprakisht (për të lejuar përgatitjen e personelit të OE) të paktën dy javë para cdo fillim integrimi’.

Për më shumë, vërejmë se:

- Numri i bankave, që do të bashkohen në këtë shërbim të përmirësuar është në varësi të vetë bankave apo vullnetit të tyre për t’ju bashkuar shërbimit. Numri maksimal i mundshëm është sa numri i bankave që do të operojnë Në Shqipëri përgjatë 3 viteve të zbatimit të kontratës (pra i papërcaktuar);
- Gjatë lëvrimit të shërbimit, OE kërkohet që brenda 6 muajve të kryej të bëj lidhjen e suksesshme me njërin nga bankat;
- Në vijim (brenda shërbimit të mirëmbajtjes, zëri 7 i tabelës ‘Mirëmbajtje e Sistemit të Faturimit Al-Billing, reader, Taksa dhe ËS të pagesave për periudhë vjecare’) operatori kërkohet të ofrojë Mbështetje teknike në procesin e lidhjes të cdo banke tjetër, që do të zbatojë Këtë shërbim.

- Për cdo lidhje të re me bankat, kërkohet që 'plani i integrime, do të përcaktohet nga UKT dhe OE do të njoftohet paraprakisht (për të lejuar përgatitjen e personelit të OE) të paktën dy javë para cdo fillim integrimi'.

.... Së teti : AK në pika 2.7 të kritereve të vecanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë vijon:

... Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

b. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

To prove the fulfillment of this criterion, economic operator must submit the following documentation for the above-mentioned employees:

b. Relevant certificates. In case the certificates are in a foreign language, the economic operator must present them translated according to the applicable legal provision in force.

Operatori ekonomik ankimes kërkon sqarim/kroigjimin e kësaj të dhëne/kërkese duke qenë se ka paqartësi përsa kohë Oferta në gjuhë të huaj pranohet.

Komisioni i shqyrtimit të Ankesave ju bën me dije se,

Përsa mësipër, gjykojmë se ankesa e operatorit ekonomik është e qëndron dhe si rrjedhojë pranohet. Njësia e prokurimit do të vijojë me hedhjen e një shtojce me ndryshimet përkatëse.[...]

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" i cili parashikon shprehimisht se : "1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët

ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 71 protokollin me datë 11.01.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3748 e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimet e shoqërisë “Primus Albania” SHPK se: “E. Në shtojcën 8 Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.2.4 keni kërkuar si më poshtë:

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Paragrafi i parë i kriterit 2.2.4 është i paqartë dhe krijon konfuzion për plotësimin e tij. Çfarë konkretisht kërkohet nga çdo anëtar i grupit dhe kush është vërtetimi i lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin ai është regjistruar sipas QKB?

Edhe vijimi i këtij kriteri me paragrafet 2, 3 dhe 4, të cilët duken pa lidhje me paragrafin 1, e thellojnë paqartësinë dhe konfuzionin në kuptimin e më pas plotësimin e këtij kriteri. Përsa më sipër kërkojmë ndërhyrjen tuaj për plotësimin/qartësimin apo heqjen e këtij kriteri.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues autoriteti kontraktor nuk e ka sqaruar këtë pikë.

III.2.2. Në nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit,

të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce.

Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave.

Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.”.

III.2.3. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për këto pretendime të ngritura në formën e sqarimit, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit me, nuk ka dhënë sqarime të hollësishme lidhur me këto konstatime të operatorit ekonomik ankimues, prandaj duhet të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik, që të shmangët çdolloj konfuzioni në radhët e operatorëve ekonomikë lidhur me hartimin e ofertës teknike dhe ekonomike dhe njëherazi për lehtësinë e punës së KVO-së në shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Akoma më tej KPP gjykon se sqarimi në rastin konkret është i nevojshëm edhe në funksion të trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe ngarkimin e tyre me të njëjtat të drejta dhe detyrime, duke shmangur kështu trajtimin diskriminues ndërmjet tyre, në kushtet kur mund të ndodhë që operatorë të ndryshëm të paraqesin oferta teknike dhe ekonomike jo në përputhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në sqarimin që do i japë ankimuesit duhet të përcaktojë qartë dhe saktë të gjitha pikat e kërkuara nga operatori ekonomik ankimues dhe të sqarojë se cili është vërtetimi i kërkuar, si dhe njëherazi të bëjë publikimin e

sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për modifikimin e kriterit 2.6 të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “... Në formulim duket sikur është kërkuar që certifikimet, kualifikimet të jenë në nivel të operatorit ekonomik. Termi “kualifikim” për një operator ekonomik (subjekt)nuk qëndron. Kualifikimet përgjithësisht i referohen individëve, punonjësve, siç janë dhe dy certifikimet, kualifikimet e kërkuara në rastin konkret.

Për sa më sipër, duke e konsideruar të paqartë dhe që krijojnë konfuzion në përmbushjen e këtij kriteri, kërkojmë korigjimin e formulimit të këtij kriteri.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr. 8, pika 2.6 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“2.6 Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë certifikimet, kualifikimet si më poshte:

- *Infrastructure Cloud;*
- *Sisteme bazash të dhenash Cloud;*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, ose certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.”

III.3.2. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.3.3. Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të

parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.3.4. Nga shqyrtimi i procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin e Prokurimit Elektronik konstatohet se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri si më poshtë:

*“ **Argumentimi:** Për këtë, vërejmë se sistemet, kryesore në projekt janë Baza të Dhënash si dhe infrastrukturë Cloud. Lidhur me zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të mësipërme, prodhuesit e programeve informatike të mirënjohur ndërkombëtarë sikurse janë Oracle apo edhe të ngjashëm, kanë ndërtuar programe trajnimi dhe kontrolli të shoqërive të cilat mundet të kryejnë shërbime që lidhen me zbatimin apo mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Në kuadër të këtyre programeve prodhuesit vendosin kriterë teknike; organizative për burimet njerëzore dhe për procedurat e brendshme të shoqërive. Këto programe/kushte ndërtohen nga vetë prodhuesit dhe ata në këtë mënyrë marrin përsipër cilësinë e shërbimeve të ofruara nga shoqëritë. Në shumë raste, kalimi i certifikimeve i kualifikon shoqëritë e IT si të autorizuar apo jo prej tyre për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes, përmiresimit apo përditësimit të sistemeve. Nëse shoqëritë nuk kanë certifikime të prodhuesit (për sisteme apo modulet) cdo ndërhyrje në sistem rezikon përfundimin e kushteve të garancisë apo të mirëmbajtjes së prodhuesit.*

Për këtë, certifikimet e mësipërme që kanë lidhje me Modulet apo sistemet që kërkohet të prokurohet jo vetëm që përbëjnë një nevojë për garantimin e cilësisë së shërbimit, por ato janë direkt të lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve për mirëmbajtjen. Ndërhyrje në sistem nga shoqëri të pa-certifikuara mundet të dëmtojë vetë sistemin, të dhënat që mbahen në sistem dhe/ose në kuadrin e sigurisë së informacionit mundet të bëhet shkak për aksesin apo demtimin e informacionit në persona apo drejtime të paautorizuara.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbeshtetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e sistemeve në kushtet e garancisë dhe pas saj. Certifikimet e mësipërme, garantojnë autoritetin Kontraktor që shërbimet e përfshira në kontrate do të levrohen janë në përputhje me kërkesat e shoqërive prodhuese Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public.”.

III.3.5. Në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes autoriteti kontraktor ka sqaruar këtë pikë si në vijim:

“Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, ose certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.

Kërkesa këtu drejtohet për Operatorët Ekonomik të certifikuar/kualifikuar dhe jo për personelin teknik apo operacional. Fjala “kualifikime” nuk mendojmë se sjell konfuzion në përgatitjen e ofertës”.

III.3.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, duke modifikuar kriterin për termin kualifikim të operatorit ekonomik. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret, që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë, se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Në argumentimin e kriterit për kualifikim autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk është shprehur mbi termin kualifiki po vetëm mbi termin certifikim gjithashtu në kthim përgjigje autoriteti kontraktor citon se: *“Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive që po ofertojnë, ose certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar.certifikuara për dhënien e tyre”*, duke sqaruar se për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqiten certifikime. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.6, duke hequr termin *“Kualifikimet”*.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për saktësimin e kriterit 2.7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“G. Në shtojca 8 Formular i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.7 në versionet shqip dhe anglisht të DST keni kërkuar respektivisht si më poshtë:*

2.7. Operatori ekonomik duhet të ketë, personel teknik, prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, qe do te angazhohet ne implementimin e projektit, duke pasur njohuri te kombinuar sipas kerkesave te meposhtme:

- *2 (dy) punonjës të certifikuar për sistemin ORACLE ;*

2.7. The economic operator must have, at least the last 3 (three) months from the date of publication of the contract notice, technical personnel, who will engage in the implementation of the project, having combined knowledge according to the following criteria:

- *2 (two) employees certified for AL-Billing system or equivalent;*

Versionet shqip dhe anglisht të kësaj kërkesë nuk përputhen.

Përsa më sipër kërkojmë ndërhyrjen tuaj për aktësimin e kësaj kërkesë nëse kërkojnë punonjës të certifikuar për sistemin Oracle apo të certifikuar për sistemin e faturimit Al-Billing.

[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën nr. 8, pika 2.7 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“2.7. Operatori ekonomik duhet të ketë, personel teknik, prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontrates, që do të angazhohet në implementimin e projektit, duke pasur njohuri të kombinuar sipas kërkesave të mëposhtme:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për zbatime sistemesh ERP
- 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme infrastrukture cloud
- 1 (një) punonjës të certifikuar për raportim të tipit BI
- 1 (një) punonjës të certifikuar për administrator e bazës së të dhënave
- 2 (dy) punonjës të certifikuar për sistemin ORACLE ;
- 2 (dy) punonjës të certifikuar për zhvillim në ëeb/mobile;

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Kontratën e punës

b. Certifikatat përkatëse. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet të paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

c. Listëpagesën e 3 muajve të fundit.

Shënim: Për pikat e mësipërme operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.”

III.4.2. Në shtojcën nr. 8, pika 2.7 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim”, të dokumenteve të tenderit në gjuhën anglisht të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“2.7. The economic operator must have, at least the last 3 (three) months from the date of publication of the contract notice, technical personnel, who will engage in the implementation of the project, having combined knowledge according to the following criteria:

- 1 (one) certified employee for ERP systems implementation
- 1 (one) employee certified for cloud infrastructure systems
- 1 (one) employee certified for BI type reporting
- 1 (one) certified employee for database administrator
- 2 (two) employees certified for AL-Billing system or equivalent;
- 2 (two) employees certified for ëeb/mobile development;

An employee may hold more than one attestation.

To prove the fulfillment of this criterion, economic operators must submit the following documentation for the above-mentioned employees:

a. The employment agreement

b. *Relevant certificates. In case the certificates are in a foreign language, the economic operator must present them translated according to the applicable legal provisions in force.*
c. *Payroll of the last 3 months.*

Note: *For the above points, the bidding economic operators must submit the self-declaration form according to appendix no. 9.*

In any case, the CA shall be hereby entitled to carry out the necessary verifications on the authenticity of the information declared by the economic operator or to ask the economic operator for clarifications and supporting documents for such clarifications.

Note: *The first qualified economic operator must submit to the CA, before the publication of the e-tender's announcement and the start of the appeal deadlines, all the evidentiary documentation for the self-declarations in the self-declaration summary form.”.*

III.4.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.4.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për saktësimin e kriterit 2.7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit në gjuhën Shqip dhe Anglisht me argumentin se në dukomunetet shqip dhe anglisht ka një mospërputhje në kriterin 2.7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i

Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere, që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e këtij kriteri duke unifikuar kriterin 2.7 në gjuhën shqipe dhe atë angleze të dokumentave të tenderit objekt prokurimi në mënyrë që mos krijohet konfuzion për operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi në momentin e ofertimit. Për këtë arsye autoriteti kontraktor në publikimin e shtojcës duhet të saktësojë kriterin 2.7 të dokumenteve të tenderit objekt prokurimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK qëndrojnë.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK për kriterin 2.8 të dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *Në shtojcën 8 Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.8 keni kërkuar si më poshtë:*

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një oferte teknike të detajuar për të gjithë kërkesat e përcaktuara në termat e referencës. Oferta teknike duhet të konsistojë minimalisht në:

- *Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik);*
- *Konfirmimin e realizimit të lidhjes për shkëmbimin e pagesave në një nga Bankat.*
- *Përgjigje për çdo kërkesë teknike të specifikuar në Termat e Referencës të sistemit.*

Shënim: *Përgjigje copy-paste të kërkesave nuk do të pranohen.*

Kjo kërkesë nuk është shoqëruar me kujtesën që ky kriter në këtë fazë plotësohet nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit.

Shtojca 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ndër të tjera shprehet si më poshtë:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

Pra, me anë të formularit të vetëdeklarimit operatori ekonomik do të deklarojë plotësimin e specifikimeve teknike (nënkpto ofertën teknike) në fazën e ofertimit elektronik të ofertave dhe kjo kërkesë pika 2.8 është në tejkallim të ligjit në këtë fazë ofertimi.

Duke konsideruar të paqartë dhe që krijon konfuzion në momentin e postimit të ofertës elektronike, kërkojmë saktësimin/plotësimin e këtij kriteri me kujtesën e përmbushjes të këtij kriteri me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit në fazën e ofertimit elektronik të ofertave.

... Në shtojcën 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/kualifikimit, kapitulli 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.8 keni kërkuar si më poshtë:

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një oferte teknike të detajuar për të gjithë kërkesat e përcaktuara në termat e referencës. Oferta teknike duhet të konsistojë minimalisht në:

Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik);

Objekti i kësaj kontrate është ofrimi i disa shërbimeve në fushën e IT (përmirësime të programeve kompjuterike, ofrim i ëeb service, licenca programesh, mirëmbajtje programesh kompjuterike, etj.) ndërkohë kërkohen materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik) që përgjithësisht i referohen dhe nënkuptojnë mallra/pajisje.

Duke e konsideruar të paqartë, jo në përputhje me shërbimet e kërkuara dhe që krijon konfuzion në përgatitjen e ofertës por edhe në vlerësimin e saj, kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë. [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën nr. 8, pika 2.8 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një oferte teknike të detajuar për të gjithë kërkesat e përcaktuara në termat e referencës. Oferta teknike duhet të konsistojë minimalisht në:

- *Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik);*
- *Konfirmimin e realizimit të lidhjes për shkëmbimin e pagesave në një nga Bankat.*
- *Përgjigje për çdo kërkesë teknike të specifikuar në Termat e Referencës të sistemit.*

Shënim: *Përgjigje copy-paste të kërkesave nuk do të pranohen.*

Shënim:

1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.

Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”.

III.5.2. Nga shqyrtimi i procesverbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në Sistemin Elektronik të Prokurimit konstatohet se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues duke u shprehur si në vijim: “**Argumentim:** Projekti kërkohet të realizohet duke u mbështetur në permiresimet dhe zbatimet e shërbimeve të kërkuara në Termat e Referencës së projektit. Në përgjigje të kërkesave të termave të referencës, kërkohet që Ofertuesi të paraqesë zgjidhjen e tij për secilën kërkesë. Këto zgjidhje kërkohet të përcaktohen në formën e përgjigjes për çdo pike/kërkesë të ToR. Përgjigjet duhet të argumentohen në zgjidhjen specifike të ofertuar, print screen nga sistemi apo referenca në datasheet apo materiale standarde të prodhuesit të sistemit. Nëse përdoren referenca të dokumentacionit standard të prodhuesit, kërkohet që këto referenca të shoqërohen me emrin e dokumentit si dhe faqen në të cilat këto kërkesa trajtohen.

Ne ToR të shërbimit, kërkohet që Operatorët Ekonomik të realizojnë një lidhje të shkëmbimit të informacionit të pagesave me bankat. Të dhenat e marra nga bankat (sipas ToR), do të përmbajne faturat e paguara, klientin si dhe shumat në menyre që sistemi i billing të bëjë lidhjen automatike. Operatori ekonomik kërkohet të ketë njohuri në këtë fushë, ndaj lidhja me njerëz nga bankat në vend, konsiderohet si i domosdoshëm për suksesin e projektit. Kjo tregon që vec aftësi teknike, operatori është njohës i proceseve si dhe i kërkesave të vecanta që lidhen me sigurinë dhe konfidencialitetin e këtij informacioni.

Vetëm nëpërmjet një dokumentimi të tillë të zgjidhjes, Autoriteti Kontraktor ka mundësinë e verifikimit të plotësisht të plotë të kërkesave të përcaktuara në ToR. Për këtë, përgjigjet në formën copy-paste nuk lejohen.”, duke mos argumentuar ligjërisht vendosjen e këtij kriteri kualifikues.

III.5.3. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” ShPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes me anë të shkresës nr. 18985/9 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 71/3 prot., datë 25.01.2024 drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim: “... Në mungesë të ofertës teknike si mësipër, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur të vlerësojë shkallën e plotësisht të kërkesave teknike specifikuar në Termat e Referencës. Për më shumë, pjesë e ofertës teknike kërkohet të jetë edhe Datasheet (katalog, apo përmbledhje e funksioneve) e produkteve/licensave të cilat janë pjesë e ofertës. Në pamundësi të vlerësimit të përputhjes së ofertës me kërkesat në Termat e Referencës, oferta do të skualifikohet.

... Referuar përcaktimeve ‘materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik)’, apo datasheet, vërejmë se, një dokument i tillë i prodhuesëve është i vlefshëm edhe për programet (jo vetëm pajisjet). Në këto dokumenta prodhuesit e sistemeve përcaktojnë teknologjinë, mjetet, funksionalitetet e ofruara si dhe mënyrën e realizimit të këtyre funksioneve.

Një dokument i tillë është mjaft i rëndësishëm për KVO për të vlerësuar që programi, apo zgjidhja e ofruar është në përputhje me kërkesat teknike dhe funksionale të projektit

(përcaktuar në ToR përkatëse). Këto dokumenta katalogë teknik të prodhuesit për më shumë mbajnë edhe kufizime të mundshme të këtyre të programeve apo moduleve, që shërbejnë edhe si bazë tjetër për vlerësimin e shkallës së përmbushjes së kërkesave. Në argumentimin e kërkesës thuhet: 'Këto zgjidhje kërkohet të përcaktohen në formën e përgjigjes për çdo pikë/kërkesë të ToR. Përgjigjet duhet të argumentohen në zgjidhjen specifike të ofertuar, print screen nga sistemi apo referenca në datasheet apo materiale standarte të prodhuesit të sistemit'.

Duke gjykuar në rëndësinë e projektit dhe impaktit të tij në operacionet ditore të UKT apo në marrëdhëniet e saj me klientët apo palët e lidhura (sikurse mundet të jenë bankat) OE kërkohet të plotësojë cdo kërkesë në ToR. Këto kërkesa janë minimale, mos përmbushja e secilës prej tyre mund të sjell skualifikimin e ofertës. Në ofertën teknike, OE kërkohet gjithashtu të referohen në katalogjet e prodhuesit.", duke mos e pranuar këto pretendime të ankimuesit.

III.5.4. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se:

"Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."*

Ndërkohë në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se:

- "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."*

III.5.5. Neni 21 pika 1 "Autoriteti ose enti kontraktor" i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon shprehimisht se: "Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj."

III.5.6. Në nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.5.7. Në nenin 82, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

III.5.8. Në nenin 41, pikat 2, 4 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

III.5.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për përzgjedhjen e fituesit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasi të përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij dhe specifikimet teknike të tyre. Pra, është

përgjegjësi e autoritetit kontraktor, si organi me interes të drejtpërdrejtë për kryerjen e procedurës së prokurimit dhe organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, të përcaktojë kriteret kualifikuese që duhet të plotësojnë ofertuesit në përputhje me kriteret dhe zërat e shërbimeve objekt-prokurimi.

Në rastin konkret, Komisioni konstaton së referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve i publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor nuk është argumentuar ligjërisht rëndësia e vendosjes së këtij kriteri për arritjen e qëllimit për të cilin po kryhet ky prokurim nga ana e autoritetit kontraktor. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë dokumentat e tenderit duke hequr kërkesën e përcaktuar në pikën 2.8 të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qendron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit *“Proçedurë e Hapur”* me Nr. REF-92678-12-29-2023, me objekt *“Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”* me fond limit 144.333.300 Lekë, pa TVSH, vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.389.423,37 (një milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre presje tridhjetë e shtatë) euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit *“Proçedurë e Hapur”* me Nr. REF-92678-12-29-2023, me objekt *“Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”* me fond limit 144.333.300 Lekë, pa TVSH, vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 1.389.423,37 (një milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre presje tridhjetë e shtatë)

euro pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

